




REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT

MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI



Drejtoria për Arsim në Deçan

07 Nr. 36365.

Deçan , dt.02.12.2016

Në bazë të kërkesave të shkollave të komunës së Deçanit , konform dispozitave të nenit 8 pika 1 dhe 2 të Ligjit të punës Nr03/L-212, nenit 23.4 (b) të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm të Kosovës si dhe nenit 5 pika (c) të Ligjit nr.03/L-068 për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Drejtoria për Arsim në Deçan, shpall :

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në këto Institucione edukative Arsimore aftësuese në komunën e Deçanit .

I. SH.F.M.U. “ A r d h m ë r i a “ në Beleg

1. Një punëtor teknik (pastrues)

II. SH.F.M.U.. “ Sylejman Vokshi“ në Prejlep.

1. Një punëtor teknik (pastrues)

KUSHTET : Kandidatët e interesuar për konkurrim për këto dy vende të lira të punës duhet të kenë të kryer – shkollën e mesme.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim :

- Çertifikata e lindjes (apo kurorëzimi për femrat e martuara),
- Diploma e shkollës së kryer në origjinal apo e legalizuar dhe
- Vërtetimi për përvojën e punës.

Të drejtat dhe obligimet realizohen me kontratë pune me rastin e punësimit. .

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Drejtoratin për Arsim në Deçan.

Konkursi mbetet i hapur në afat kohor prej 8 ditësh nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik ditor.

Drejtori,
Qazim Maloku